



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË

30.06.2020.

Zyra e Personelit

Nr.01/

Më:30/06/2020

01-584

Në mbështetje të dispozitave të nenit 18 dhe nenit 27, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5, i të Rregullores Nr. 21/2012, për Avancim në Karrierë të Nëpunësve, si dhe neni 16, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.7, të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM

I. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

1.(Një) Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara: Diplomën e Fakultetit Juridik/Ekonomik apo ndonjë Fakultet që lidet me këtë vend të punës

Përvojë pune: 4 vite përvojë pune profesionale;

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës.

Koeficienti: 7.

Kodi i vendit të punës RB/040

Numri i referencës: RN0006040

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Përpilon Programin dhe Planin e punës

-Është përgjegjës për sektorin e vet.

-Organizon dhe koordinon kryerjen e punëve në sektor.

-Bënë unifikimin e planit vjetor të punës dhe mbikëqyrë realizimin e tij, koordinon punët në hartimin e informativëve, raporteve, analizave et

-Është përgjegjës për kryerjen e punëve me sukses në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

-Jep aplikacionet udhëzimet dhe këshilla të nevojshme qytetarëve të interesuar për regjistrim të biznesit

-Pranon aplikacionet dhe bën regjistrimin e bizneseve të reja brenda territorit të komunës, në harmoni me rregullat dhe kriteret e përcaktuara me aktet ligjore, në fuqi, të RKS

-Bën licencimin e të gjitha bizneseve duke përfshirë bizneset e cilësuara si: shoqërore, shtetërore, private.

Dokumentet e kërkuara

-Diploma universitare

-Letërnjoftimi (fotokopje);

-Certifikata e lindjes;

-Certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi që nuk është nën hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve** të KK- Malishevë. Konkursi do të publikohet në të përditshmen "Epoka e re", në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelë të shpalljeve të KK- Malishevë.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.